



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 222, Datë 10.07.2023

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2023 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.07.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1732/3 prot., datë 07.07.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Qershor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 5024 prot., datë 30.06.2023, protokolluar me tonën me nr. 1732/2 prot., datë 03.07.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Qershor 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a., vihet re se shoqëria vijon të përfshijë ndër të përlllogaritjen e këtij çmimi kostot e disbalancave. ERE në mënyrë të përsëritur ka sqaruar shoqërinë se bazuar në nenin 6, pika 3 dhe pika 5 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar, tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë tek klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë, për periudhën e lëvrimit. Mbi këtë tarifë do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Sikurse përcaktuar në metodologji, kostot e imbalancave do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi.

- Mbështetur në nenin 8 të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Qershor 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
 - Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022 të bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë në vlerën 1.06 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.
- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, e ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Qershor 2023, përlogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin qershor 2023</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt	çmimi i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh 10.45
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh 0.31
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh 1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh 0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh 1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh 14.22

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
 - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *14.22 Lekë/kWh për muajin Qershor 2023*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin Qershor 2023, prej 14.22 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI